



HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A

Nr. I/201

Datë: 14.11.2024

Bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr. I/157, të datës 30.10.2024, për formimin e Komisionit për Seleksionimin e Kandidatëve në Konkursin e datës 01.10.2024 për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv, duke pasur parasysh kushtet dhe kriteret e kualifikimit të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe në Konkursin e datës 01.10.2024, Komisioni për Seleksionimin e Kandidatëve, pas shqyrtimit të aplikacioneve në këtë Konkurs, njëzëri mori këtë:

VENDIM

- I. Për krijimin e listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e kualifikimit për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv sipas Konkursit të datës 01.10.2024:
 1. Agron Statovci;
 2. Mahir Blaku;
 3. Valerie Bojku.
- II. Të gjithë kandidatët, në listën si më lart, i propozohen Bordit të Drejtorëve për intervistim për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv sipas Konkursit të datës 01.10.2024.

Arsyetim

Brenda afatit sa konkursi ka qenë i hapur, 01 tetor deri më 31 tetor 2024, kanë qenë gjithsejtë tri (3) aplikime, dy (2) prej tyre përmes email-it dhe një (1) prej tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik në arkivin e Ndërmarrjes. Duke pasur parasysh kushtet dhe kriteret ligjore, të cilat është kërkuar që të plotësohen nga kandidatët në Konkursin për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv, të publikuar më 01.10.2024, Komisioni pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të aplikantëve në këtë Konkurs, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Radhitja e listës së kandidatëve, si në dispozitiv të këtij vendimi, është bërë në bazë të alfabetit. Kandidatët do të ftohen në intervistë përmes telefonit dhe adresave elektronike së paku 48 orë para mbajtjes së intervistës.

Në emër të Komisionit Seleksionues

Vjollca Salihu, Kryetare

